



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-4452/24
Kaçanik, 29.02.2024

Në mbështetje të nenit **11**, nenit **12** paragrafi **2**, shkronja **(d)** dhe nenit **17**, shkronja **(c)** të Ligjit NR.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), nenit **17**, të ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe rregullore (qrk) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni **17**, të nenit **6** paragrafi **1, 2** shkronja **(h)** dhe **(q)** e Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.104/02-4452/24 prej datës 15.02.2024 nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Kuvendi Komunal Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 shkurt 2024, merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTEZIM AFATGJATË PËR 99 VITE TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë Vendim, formohet komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në përbërje prej 5 anëtarëve, prej tyre dy (2) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, dy (2) anëtarë të propozuar nga Kuvendi i Komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit dhe një (1) anëtar ekspert nga shoqëria civile.
2. Komisioni si në pikën 1 të këtij Vendimi, ka këtë përbërje:
 1. Gentiana Sallahu anëtar (ekzekutivi)
 2. Afrim Fuga anëtar (ekzekutivi)
 3. Selajdin Troni anëtar (PDK)
 4. Adnan Reka anëtar (LVV)
 5. Faton Bela anëtar (Shoqëria Civile).
3. Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës është përgjegjës: Të sigurojë që konkursi i hapur të mbahet në përputhje me procedurat e Ligjit dhe Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të sigurojë që dokumentet të janë në dispozicion për pjesëmarrësit në konkurrim, të sigurojë që konkursi është shpallur në web-faqen e komunës dhe tabelën e komunës për shpallje publike, të sigurojë konfidencialitet për personat ose subjektet që marrin pjesë në konkurrim.
4. Komisioni vlerësues i formuar me këtë vendim, do të zhvilloj procedurën vetëm për pronat të cilat do të jepen në shfrytëzim sipas Vendimit Paraprak 01Nr. 350/01-4450/24 të aprovuar me 29.02.2024.

5. Organet relevante të administratës dhe njësitë tjera të organeve të saja, do t'i ofrojnë përkrahje Komisionit Vlerësues.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Komisioni, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

